

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

- “Blerje kolonetash parkimi+barriera dhe tra”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

- Pajisje elektronike – 31710000-6; Barriera sigurie – 34928310-4.

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

- 2.000.000 (dy milion) lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor – Autoriteti Portual Durrës – ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*Sipas përcaktimeve në shtojcën 7 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit” dhe në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”.*

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2020-2021-2022), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

### ***Argumentimi:***

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c e 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

## **2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

### **Argumentimi:**

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenet 40, pika 4 e 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë CE, për mallrat pjese e procedurës së prokurimit, **në vecanti për: 1) Koloneta parkimi; 2) Barriera me tra 4 metër.**

### **Argumentimi:**

*Në bazë të nenit 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se mallrat dhe shërbimet lidhur me objektin e prokurimit, i plotësojnë kërkesat e cilësisë.*

*Shenjimi CE për mallrat është një detyrim për çdo pajisje që tregtohet në Republikën e Shqipërisë. Shenjimi CE përveçse detyrim ligjor për çdo pajisje fizike është edhe një garanci që pajisjet janë të një standarti, cilësie të lartë.*

**2.3.3** Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike të ngarkuar në SPE nga Autoriteti Kontraktor në formën e një tablele kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- a. Emri i kompanisë prodhuese ose distributori i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit. Adresa dhe web-siti të sakta të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.
- b. Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.

- c. Nr. i faqes në katalog referuar Nr.Idetifikues te artikullit të ofruar sipas listës i shenuar me nje shenje dalluese.

### **Argumentimi:**

*Ky kriter është menduar për t'i dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur në përputhje me nenin 40, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.*

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i certifikuar si me poshtë. Për plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesi duhet te paraqesë certifikatën e kërkuar për:

- ISO 9001 (e vlefshme) ose ekuivalente.

Certifikimi i kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzoje certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

### **Argumentimi**

*Ky kriter është vendosur në përputhje me 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.*

*Duke qene se paisjet e kerkuara jane per sisteme sigurie si dhe teknologjia e kerkuar eshte e nje niveli te larte duhet qe subjektet zbatuese te kontrates te jene te pajisura me keto certifikime.*

*Përmbushja e standartit ISO 9001 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së mallrave dhe shërbimeve që kerkohen. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me pajisjet elektronike duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre artikujve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

*Në përcaktimin e specifikimeve teknike për artikujt, objekt i kësaj procedure prokurimi (koloneta parkimi+barriera dhe tra), janë vendosur në përputhje me nevojat e institucionit për të garantuar funksionimin e ambjenteve të reja të parkimit si edhe zëvendesimin e pajisjeve ekzistuese.*

*Për sa më sipër, specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme e saktë e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “ekuivalent” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.*

**Afati i lëvrimit të produktit/shërbimit do të jetë 90 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.**

**KOMISIONI:**